



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura VIII**  
*Sesioni pranveror*

**Komisioni për Mjedis, Ushqim, Bujqësi, Planifikim dhe Zhvillim**

**RAPORTI I PUNËS PËR VITIN**  
**2021**

26 janar, 2022

## PËRMBAJTJA

II PËRBËRJA DHE STRUKTURA E KOMISIONIT .....	4
III AKTIVITETET E KOMISIONIT .....	5
a) Mbledhjet e Komisionit .....	5
b) Grupet e punës .....	6
c) Shqyrtimi i projektligjeve .....	7
d) Nismat legislative të Komisionit.....	9
e) Shqyrtimi i raporteve vjetore për punën e institucioneve raportuese .....	9
f) Shqyrtimi i kërkesave të institucioneve publike dhe private .....	10
g) Mbajtja e dëgjimeve publike.....	11
h) Mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve .....	11
i) Vizitat e komisionit brenda dhe jashtë vendit.....	12
j) Pritja e delegacioneve parlamentare të huaja (homologe) .....	13
k) Aktivitete të tjera të kryetares dhe anëtarëve të komisionit.....	14
IV REZYME E PUNËS SË KOMISIONIT .....	16

## I HYRJE

Komisioni për Mjedis, Ushqim, Bujqësi, Planifikim dhe Zhvillim<sup>1</sup>, në bazë të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës, është Komision Funkcional, i cili në kuadër të fushëveprimit dhe të përgjegjësisë, i shqyrton të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me fushën e bujqësisë, sigurimit dhe sigurisë së ushqimit, pylltarisë, zhvillimit rural, mbrojtjes së mjedisit, ujërave, planifikimit hapësinor, ndërtimit, banimit, kadastrit, transportit rrugor, hekurudhor, ajror, detar dhe sigurisë në rrugë.

Ky raport është përgatitur me qëllim të pasqyrimin të punës së komisionit për vitin 2021, i cili përmban të dhënat që tregojnë për aktivitetet e zhvilluara dhe realizimin e objektivave të planit të punës. Bazuar në planin e punës për vitin 2021 në komision janë planifikuar të shqyrtohen 43 projektligje bazuar në Programin Legjislativ të Qeverisë për vitin 2021. Ndërsa deri më tash janë proceduar për shqyrtim 32 projektligje, prej tyre 31 të sponsoruara nga Qeveria dhe 1 nismë e deputetëve; 3 projektligje janë tërheqë nga programi legjislativ dhe 9 projektligje nuk janë proceduar. Prej projektligjeve të proceduara: 2 ligje janë miratuar, 1 projektligj është në komisionet e përhershme, 7 projektligje janë në procedurë në komision pasi që janë miratuar në parim nga Kuvendi, 20 projektligje janë para leximit në parim në seancë dhe 2 projektligje u janë shpërndarë deputetëve.

Për të realizuar planin e vet, komisioni ka mbajtur 25 mbledhje të rregullta, formoi 12 grupe të punës, ka filluar mbikëqyrjen e zbatimit të 4 ligjeve, ka realizuar 18 vizita nëpër institucionet qendrore, lokale dhe në terren. Mbledhjet e komisionit kanë qenë të hapura dhe janë përcjellë nga mediat dhe institucionet e tjera mbështetëse të punës së Kuvendit. Në mbledhjet e komisionit janë ftuar dhe kanë marrë pjesë, ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, ministri i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, drejtori i Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale, drejtori dhe Bordi i Autoritetit të Aviacionit Civil, drejtori dhe Bordi i Autoritetit Rregullator të Hekurudhave dhe drejtori i Agjencisë për Shërbimet e Navigacionit Ajror.

Gjithashtu gjatë këtij viti, komisioni ka realizuar takim me një delegacion të ish-anëtarëve të Kongresit të SHBA-së dhe kanë marrë pjesë në trajnimin e organizuar nga Instituti Republikan Ndërkombëtar, gjatë të cilit është realizuar një bashkëbisedim në platformën ZOOM me 2 anëtar të Kongresit Amerikan. Ndërsa komisioni ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me dy organizata ndërkombëtare: “Friedrich Ebert Stiftung” dhe “UN-Habitat”, si dhe me dy organizata vendore: “Fondacioni Jeshil” dhe “Swiss Solidar”.

Kryetarja e komisionit, realizoi edhe takime të tjera me institucione dhe organizata ndërkombëtare: me Viola von Cramon raportuese e Parlamentit Evropian për Kosovën, deputeten e Parlamentit të Vjenës znj. Mag. Heidi Sequenz, një grup deputetesh me delegacionin nga vendet e Vishegradit, takim virtual me kryetarin e Komisionit për Bujqësi të Parlamentit të Italisë, pjesëmarrja në seancën plenare të Procesit të Bashkëpunimit të Evropës Juglindore në Antalya të Turqisë, me Zyrën e BE-së, si dhe shumë takime të tjera me qytetarë, OJQ vendore dhe ndërkombëtarë, ekspertë të fushave të ndryshme, me të cilat ka biseduar për problematikat e ndryshme dhe mundësitë e bashkëpunimit.

<sup>1</sup> Me vendimin e Kuvendit e Kuvendit nr. 08-V-140, të datës 6.12.2021, emri i deritanishëm “Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis, Planifikim Hapësinor dhe Infrastrukturë” ndryshohet në “Komisioni për Mjedis, Ushqim, Bujqësi, Planifikim dhe Zhvillim”.

## II PËRBËRJA DHE STRUKTURA E KOMISIONIT

### Anëtarët e Komisionit:

1. Fitore Pacolli-Dalipi, kryetare, (GP –LVV);
2. Besian Mustafa, zëvendëskryetar i parë, (GP–LDK);
3. Zoran Mojsiloviq, zëvendëskryetar i dytë, (GP–LS);
4. Milazim Salijaj, anëtar, (GP–LVV);
5. Salih Zyba, anëtar, (GP–LVV);
6. Ekrem Mustafa, anëtar, (GP – LVV);
7. Jetmira Vrenezi<sup>2</sup>, anëtare, (GP– LVV);
8. Isak Shabani<sup>3</sup>, anëtar, (GP– PDK);
9. Ganimete Musliu<sup>4</sup>, anëtare, (GP–PDK);
10. Albena Reshitaj, anëtare, (GP–AAK) dhe
11. Samra Ilijazi, anëtare (GP– Multietnik)

### Njësia për mbështetjen e komisionit:

Bajram Badivuku, koordinator  
tel.: 038-211-184 / ext 10 608  
e-mail: bajram.badivuku@assembly-kosova.org

Ylber Sherifi, zyrtar i lartë i fushës /analist  
Tel.: 038-213-664 / ext 10 639  
Email: ylber.sherifi@assembly-kosova.org

---

<sup>2</sup> Me vendimin e Kuvendit të dates 25.11.2021, deputetja Jetmira Vrenezi emërohet anëtare në Komisionin për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis, Planifikim Hapësinor dhe Infrastruktura, në vend të deputetes Arbëreshë Kryeziu-Hyseni. Deputetja Arbëreshë Kryeziu-Hyseni ishte emëruar anëtare në Komision, në vend të deputetes Jetmira Vrenezi me vendim të Kuvendit të dates 24.06.2021.

<sup>3</sup> Me vendimin e Kuvendit të dates 25.11.2021, deputeti Isak Shabani emërohet anëtar në Komisionin për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Ruial, Mjedis, Planifikim Hapësinor dhe Infrastrukturg, në vend të ish-deputetit Fadil Nura.

<sup>4</sup> Me vendimin e Kuvendit të dates 25.11.2021, deputetja Ganimete Musliu emërohet anëtare në Komisionin për Bujqësi, Pylltari Zhvillim Rural, Mjedis, Planifikim Hapësinor dhe Infrastrukturë, në vend të deputetit Bekim Haxhiu.

### III AKTIVITETET E KOMISIONIT

#### a) *Mbledhjet e Komisionit*

Komisioni për Mjedis, Ushqim, Bujqësi, Planifikim dhe Zhvillim, gjatë vitit 2021 ka mbajtur 25 mbledhje (me 125 pika të rendit të ditës). Mbledhja e parë konstituive për Legjislaturën VIII, është mbajtur më 13 prill 2021, ndërsa në mbledhjen e mbajtur më 31 maj 2021, komisioni e miratoi planin e punës për vitin 2021. Në mbledhjet e komisionit janë ftuar dhe kanë marrë pjesë, ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, ministri i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, drejtori i Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale, drejtori dhe Bordi i Autoritetit të Aviacionit Civil, drejtori dhe Bordi i Autoritetit Rregullator të Hekurudhave dhe drejtori i Agjencisë për Shërbimet e Navigacionit Ajror:

- Bislim Zogaj, drejtor Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës, ka marrë pjesë në 2 mbledhje të komisionit: më 5 maj 2021, ku është shqyrtuar Raporti vjetor i Agjencisë për vitin 2020 si dhe *në mbledhjen e mbajtur më 7 dhjetor 2021*, ku është shqyrtuar Plani i performancës të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës për vitin 2022.
- Bujar Ejupi, drejtor i Përgjithshëm, Nora Bakalli dhe Kushtrim Musa nga Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës (AAC), kanë marrë pjesë në 3 mbledhje të komisionit: më 5 dhe 25 maj 2021, ku është shqyrtuar Raporti vjetor i AAC-së për vitin 2020 si dhe *më 23 dhjetor 2021* ku është shqyrtuar Plani i performancës të Autoritetit të Aviacionit Civil për vitin 2022.
- Skender Halili, kryesues dhe Ardian Gaxherri, Myzejene Selmani, Nazlije Krasniqi- Korçaj, Jeton Paloka, anëtarë të Bordit mbikëqyrës të AAC-së, kanë marrë pjesë në mbledhjen e mbajtur më 18 maj 2021, ku është shqyrtuar Raporti vjetor i AAC-së për vitin 2020.
- Bahri Nuredini, drejtor; Merita Makolli dhe Alban Sylaj nga Agjencia për Shërbimet e Navigacionit Ajror (ASHNA), kanë marrë pjesë në mbledhjen e mbajtur më 25 maj 2021, ku është shqyrtuar Raporti vjetor i AAC-së për vitin 2020.
- Shkelzen Qorri, drejtor i Përgjithshëm i ARH-së dhe Bordi i ARH-së: Arsim Berisha, kryesues, Ilmi Ahmeti, Gëzim Qerimi dhe Shkumbin Hyseni, anëtarë, kanë marrë pjesë në mbledhjen e mbajtur më 1 qershor 2021, ku është shqyrtuar Raporti vjetor i ARH-së për vitin 2020.
- Ministri i MBPZHR-së, Z. Faton Peci, ka marrë pjesë në 3 mbledhje të komisionit: më 29 qershor 2021, ka raportuar për planet dhe prioritetet e ministrisë për vitin 2021 si dhe më 14 dhe 21 dhjetor 2021 ka raportuar për të arriturat e ministrisë gjatë këtij viti.
- Zëvendësministrja e MMPHI-së, Znj. Linda Çavdarbasha, ka marrë pjesë në mbledhjen e mbajtur më 27 tetor 2021, ku është shqyrtuar Raporti vjetor për Gjendjen e Mjedisit në Kosove për vitin 2020.

Mbledhjet e Komisionit kanë qenë të hapura dhe janë përcjellë nga mediat dhe institucionet e tjera mbështetëse të punës së Kuvendit.

**b) Grupet e punës**

Komisioni, gjatë këtij viti formoi 11 grupe të punës, për shqyrtimin e projektligjeve dhe për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve, e të cilat i kanë mbajtur 16 mbledhje.

- Grupi i punës për shqyrtimin e Projektligjit nr.08/L-012 për Odat e Arkitektëve dhe Inxhinierëve në fushën e ndërtimit, është formuar më 27.10.2021, në këtë përbërje: Milazim Salijaj-kryesues, Ekrem Mustafa dhe Fitore Pacolli-Dalipi, anëtarë.
- Grupi i punës për shqyrtimin e Projektligjit nr.08/L-011 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-061 për Shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, është formuar më 27.10.2021, në këtë përbërje: Milazim Salijaj-kryesues, Ekrem Mustafa dhe Fitore Pacolli-Dalipi, anëtarë.
- Grupi i punës për shqyrtimin e Projektligjit nr.08/L-010 për Krijimin e Infrastrukturës Kombëtare të informacionit Hapësinor në Republikën e Kosovës, është formuar më 27.10.2021 në këtë përbërje: Salih Zyba-kryesues, Milazim Salijaj, Isak Shabani dhe Fitore Pacolli-Dalipi- anëtarë.
- Grupi i punës për shqyrtimin e Projektligjit 08/L-025 për Mbrojtjen e ajrit nga ndotja, është formuar më 27.10.2021 në këtë përbërje: Arbëreshë Kryeziu-Hyseni, kryesuese, Samra Ilijazi dhe Fitore Pacolli-Dalipi – anëtarë.
- Grupi i punës për shqyrtimin e Projektligjit 08/L-027 për Mbeturinën nga industritë nxjerrëse të mineraleve, është formuar më 27.10.2021 (plotësimi 7.12.'21) në këtë përbërje: Ekrem Mustafa- kryesues, Ganimete Musliu dhe Salih Zyba– anëtar.
- Grupi i punës për shqyrtimin e Projektligjit nr. 08/L-058 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-074 për Shërbime këshilluese për bujqësi dhe zhvillim rural, është formuar më 7.12.2021 në këtë përbërje: Besian Mustafa-kryesues, Isak Shabani, Milazim Salijaj, Fitore Pacolli-Dalipi- anëtar.
- Grupi i punës për nismën e komisionit: Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-088 për rregullat e trafikut rrugor: është formuar më 27.10.'21 (plotësimi 7.12.'21): Fitore Pacolli-Dalipi, kryesues, Ekrem Mustafa, Salih Zyba- dhe Ganimete Musliu- anëtarë.
- Grupi i punës për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës, është formuar më 13.7.'21 (plotësimi 7.12.'21): Albena Reshitaj-kryesuese, Jetmira Vrenezi, Ganimete Musliu, Milazim Salijaj dhe Fitore Pacolli-Dalipi, anëtar.
- Grupi i punës për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr.04/L-114 për Pasurimin e Miellit, është formuar më 13.7.'21 (plotësimi 7.12.'21) në këtë përbërje: Besian Mustafa-kryesues, Milazim Salijaj, Ganimete Musliu dhe Fitore Pacolli-Dalipi, anëtar.
- Grupi i punës për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit Nr. 2003/3 për Pyjet e Kosovës, është formuar më 13.7.'21 (plotësimi 7.12.'21) në këtë përbërje: Salih Zyba-kryesues, Isak Shabani, Besian Mustafa, Ekrem Mustafa, Samra Ilijazi dhe Fitore Pacolli-Dalipi, anëtar.
- Grupi i punës për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 2003/5 për farërat, është formuar më 13.7.'21 (plotësimi 7.12.'21), në këtë përbërje: Ganimete Musliu - kryesuese, Salih Zyba, Jetmira Vrenezi, Besian Mustafa dhe Fitore Pacolli-Dalipi- anëtar.

**c) Shqyrtimi i projektligjeve**

Bazuar në planin e punës për vitin 2021 në komision janë planifikuar të shqyrtohen 43 projektligje bazuar në Programin Legjislativ të Qeverisë për vitin 2021. Ndërsa deri më tash janë proceduar për shqyrtim 32 projektligje, prej tyre 31 të sponsoruara nga Qeveria dhe 1 nismë e deputetëve; 3 projektligje janë tërheqë nga programi legjislativ dhe 9 projektligje nuk janë proceduar. Prej projektligjeve të proceduara: 2 ligje janë miratuar, 1 projektligj është në komisionet e përhershme, 7 projektligje janë në procedurë në komision pasi që janë miratuar në parim nga Kuvendi, 20 projektligje janë para leximit në parim në seancë dhe 2 projektligje u janë shpërndarë deputetëve.

1. *Projektligji nr.08/L-004 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-132 për Automjete* - komisioni në mbledhjen e mbajtur më 8 qershor 2021, e shqyrtoi në parim projektligjin dhe i rekomandoi Kuvendit miratimin e tij. Në mbledhjen e mbajtur më 13 korrik 2021, e miratoi raportin me amendamente për komisionet e përhershme. Më 19 korrik 2021, e miratoi Raportin me rekomandime për seancë. Ligji është miratuar nga Kuvendi më 22 korrik 2021.
2. *Projektligji nr.08/L-012 për Odat e Arkitektëve dhe Inxhinierëve në fushën e ndërtimit* - komisioni në mbledhjen e mbajtur më 13 korrik 2021, e shqyrtoi në parim projektligjin dhe i rekomandoi Kuvendit miratimin e tij. Kuvendi më 22 korrik 2021 e miratoi në parim. Komisioni më 14 dhjetor 2021, e miratoi raportin me amendamente për komisionet e përhershme, ndërsa më 21 dhjetor 2021 e miratoi Raportin me rekomandime për seancë. Ligji është miratuar nga Kuvendi më 24 dhjetor 2021.
3. *Projektligji nr.08/L-011 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-061 për Shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore* – komisioni në mbledhjen e mbajtur më 13 korrik 2021, e shqyrtoi në parim projektligjin dhe i rekomandoi Kuvendit miratimin e tij. Kuvendi më 22 korrik 2021 e miratoi në parim. Komisioni më 21 dhjetor 2021, e miratoi raportin me amendamente dhe është dërguar në komisionet e përhershme.
4. *Projektligji nr.08/L-010 për Krijimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Hapësinor* - komisioni në mbledhjen e mbajtur më 13 korrik 2021, e shqyrtoi në parim projektligjin dhe i rekomandoi Kuvendit miratimin e tij. Kuvendi më 22 korrik 2021 e miratoi në parim.
5. *Projektligji nr.08/L-025 për mbrojtjen e ajrit nga ndotja* - komisioni në mbledhjen e mbajtur më 27 korrik 2021, e shqyrtoi në parim projektligjin dhe i rekomandoi Kuvendit miratimin e tij. Kuvendi më 6 gusht 2021 e miratoi në parim.
6. *Projektligji nr.08/L-027 për Mbeturinat nga Industria e Nxjerrjes së Mineraleve* - komisioni në mbledhjen e mbajtur më 27 korrik 2021, e shqyrtoi në parim projektligjin dhe i rekomandoi Kuvendit miratimin e tij. Kuvendi më 6 gusht 2021 e miratoi në parim.
7. *Projektligji nr. 08/L-058 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-074 për Shërbime këshilluese për bujqësi dhe zhvillim rural*- komisioni në mbledhjen e mbajtur më 9 nëntor 2021, e shqyrtoi në parim projektligjin dhe i rekomandoi Kuvendit miratimin e tij. Kuvendi më 19 nëntor 2021 e miratoi në parim.
8. *Projektligji nr. 08/L-065 për Produktet Biocide*- komisioni në mbledhjen e mbajtur më 16 nëntor 2021, e shqyrtoi në parim projektligjin dhe i rekomandoi Kuvendit miratimin e tij. Kuvendi më 17 dhjetor 2021 e miratoi në parim.

9. *Projektligji nr. 08/L-072 për Bujqësi dhe zhvillim rural-* komisioni në mbledhjen e mbajtur më 23 nëntor 2021, e shqyrtoi në parim projektligjin dhe i rekomandoi Kuvendit miratimin e tij. Kuvendi më 13 dhjetor 2021 e miratoi në parim.
10. *Projektligji nr. 08/L-070 për pijet e forta alkoolike-* komisioni në mbledhjen e mbajtur më 23 nëntor 2021, e shqyrtoi në parim projektligjin dhe i rekomandoi Kuvendit miratimin e tij. Kuvendi më 13 dhjetor 2021 e miratoi në parim.
11. *Projektligji nr. 08/L-071 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-060 për Mbeturina-* komisioni në mbledhjen e mbajtur më 23 nëntor 2021, e shqyrtoi në parim projektligjin dhe i rekomandoi Kuvendit miratimin e tij. Kuvendi më 13 dhjetor 2021, e kishte për shqyrtim por në mungese e ministrit nuk u shqyrtua.

Komisioni në mbledhjen e mbajtur më 14 dhjetor 2021, i shqyrtoi në parim 19 projektligjet në pako, të cilat janë ndryshim plotësim të ligjeve për harmonizim me dispozitat me Ligjin për Kundërvajtje dhe i rekomandoi Kuvendit miratimin. Janë në pritje për shqyrtim në parim në seancë.

12. *Projektligji nr. 08/L-082 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-120 për Mbrojtjen e Bimëve;*
13. *Projektligji nr. 08/L-078 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-041 për Prodhimin, Grumbullimin, Përpunimin dhe Tregtimin e Duhanit;*
14. *Projektligji nr. 08/L-087 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-040 për Rregullimin e Tokës;*
15. *Projektligji nr. 08/L-091 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2004/21 për Veterinarinë;*
16. *Projektligji nr. 08/L-089 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2003/10 Ligji për Plehrat Artificiale;*
17. *Projektligji nr. 08/L-080 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2003/5 i Kosovës për farërat;*
18. *Projektligji nr. 08/L-085 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/13 për Materialin Fidanor;*
19. *Projektligji nr. 08/L-084 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-53 për Gjuetinë;*
20. *Projektligji nr. 08/L-094 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-198 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-9 për Ujitjen e Tokave Bujqësore;*
21. *Projektligji nr. 08/L-083 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-8 për Verërat;*
22. *Projektligji nr. 08/L-090 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.02/L-10 për Përkujdesjen ndaj Kafshëve;*
23. *Projektligji nr. 08/L-079 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-85 për Peshkatari dhe Akuakulturë;*
24. *Projektligji nr. 08/L-088 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.02-L-111 për bletari;*
25. *Projektligji nr. 08/L-093 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-042 i Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve;*



26. *Projektligji nr. 08/L-092 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-029 për Inspektionin Bujqësor;*
27. *Projektligji nr. 08/L-095 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/9 Ligji për Kooperativat e Bujqëve;*
28. *Projektligji nr. 08/L-077 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-127 për Regjistrimin e Bujqësisë;*
29. *Projektligji nr. 08/L-081 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-085 për bujqësi organike;*
30. *Projektligji nr. 08/L-086 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-114 për Pasurimin e Miellit.*

Dy projektligje u janë shpërndarë deputetëve më 29 dhjetor 2021:

31. *Projektligji nr. 08/L-112 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-26 për tokën bujqësore;*
32. *Projektligji nr. 08/L-116 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-197 për kimikate.*

#### **d) Nismat legislative të Komisionit**

Komisioni ka ndërmarrë një nismë legislative, për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-088 për rregullat e trafikut rrugor. Vendimin e ka marrë në mbledhjen e mbajtur më 27 tetor 2021 dhe formoi Grupin e punës (grupi i punës u plotësua më 7 dhjetor 2021) në këtë përbërje: *Fitore Pacolli-Dalipi, kryesues, Ekrem Mustafa, Salih Zyba- dhe Ganimete Musliu- anëtarë.*

#### **e) Shqyrtimi i raporteve vjetore për punën e institucioneve raportuese**

Komisioni gjatë kësaj periudhe ka shqyrtuar 4 raporte të agjencive raportuese dhe 2 plane të performances per vitin 2022.

- *Raporti vjetor i Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës, për vitin 2020 - komisioni e shqyrtoi raportin në mbledhjen e mbajtur më 5 maj 2021, pastaj më 11 maj 2021 realizoi një vizitë pune në këtë Agjenci, ndërsa në mbledhjen e mbajtur më 1 qershor 2021, i rekomandoi Kuvendit të mos e miratojë raportin. Kuvendi në mbledhjen e mbajtur më 4 nëntor 2021 nuk e miratoi.*
- *Raporti vjetor i Autoritetit të Aviacionit Civil i Republikës së Kosovës, për vitin 2020 - komisioni e shqyrtoi raportin në 4 mbledhje: Raportin e paraqiti para deputetëve drejtori i Përgjithshëm i AAC-së më 5 maj 2021; më 18 maj 2021 është ftuar Bordi mbikëqyrës i AAC-së; ndërsa më 31 maj 2021 bashkë me drejtorin e Agjencisë për Shërbimin e Navigacionit Ajror dhe drejtorin e AAC-së. Ndërsa në mbledhjen e mbajtur më 1 qershor 2021, i rekomandoi Kuvendit të mos e miratojë raportin. Kuvendi në mbledhjen e mbajtur më 6 dhjetor 2021 nuk e miratoi.*
- *Raporti vjetor i Autoritetit Rregullativ për Hekurudha, për vitin 2020 - komisioni në mbledhjen e mbajtur më 1 qershor 2021, e shqyrtoi Raportin vjetor të punës të ARH-së për*

vitin 2020, të cilin e paraqiti para deputetëve drejtori i Përgjithshëm i ARH-së i shoqëruar nga Bordi i ARH-së. Ndërsa në mbledhjen e mbajtur më 8 qershor 2021, i rekomandoi Kuvendit të mos e miratojë raportin. Kuvendi akoma nuk e ka shqyrtuar.

Në mbledhjen e mbajtur më 2 korrik 2021, komisioni i rekomandoi Kuvendit shkarkimin e Bordit të ARH-se dhe Kuvendi më 21 korrik 2021 e shkarkoi Bordin e ARH-se.

- Raporti vjetor për Gjendjen e Mjedisit në Kosove për vitin 2020. Komisioni, në mbledhjen e mbajtur më 27.10.2021, shqyrtoi Raportin vjetor për gjendjen e mjedisit në Kosovë për vitin 2020, të cilin e paraqiti para deputetëve Zëvendësministrja e MMPHI-së, së bashku me përfaqësuesin e Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës dhe i rekomandoi Kuvendit miratimin e tij. Kuvendi në mbledhjen e mbajtur më 22.11.2021 e miratoi.
- Plani i performancës të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës për vitin 2022- *Komisioni në mbledhjen e mbajtur më 7 dhjetor 2021 e shqyrtoi dhe e miratoi Planin e Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës për vitin 2022.*
- Plani i performancës të Autoritetit të Aviacionit Civil për vitin 2022- - *Komisioni në mbledhjen e mbajtur më 23 dhjetor 2021 e shqyrtoi dhe e miratoi planin e performancës për vitin 2022 të Autoritetit të Aviacionit Civil për vitin 2022.*

**f) *Shqyrtimi i kërkesave të institucioneve publike dhe private***

Komisioni, në periudhën raportuese, ka shqyrtuar këto kërkesa:

- Kërkesat e banorëve të Shalës së Komunës së Lipjanit, kundër një gurëthyesi që ka filluar punën dhe kërkesa e tyre t'i rekomandohet ministrisë që të pezullojë përkohësisht punimet. Komisioni e ka shqyrtuar dhe ka dalë në terren.
- Kërkesa e banorëve të Miradi të Ulët të Komunës së Fushë Kosovës rreth ndotjes së lumit Graçanka nga hedhja e mbetjeve të qumështit dhe ujërat e zeza. Komisioni e ka shqyrtuar dhe ka dalë në terren.
- Kërkesa e banorëve të Kërvasëris së Malishevës, kundër gurëthyesit që operon dhe kërkesa e tyre me u ndal punimet. Komisioni e ka shqyrtuar dhe ka dalë në terren.
- Kërkesa e banorëve të fshatit Shkozë të Prizrenit, kundër gurthyesit që operon dhe kërkesa e tyre që ti shikohet a po i plotëson kushtet e operimit. Komisioni e ka shqyrtuar dhe ka dalë në terren.
- Kërkesa dhe peticion me 4300 nënshkrime të qytetarëve të fshatit Gremnik të Komunës së Klinës kundër ndërtimit të fabrikës së çimentos. Komisioni e ka shqyrtuar dhe ka dalë në terren.
- Kërkesa e banorëve të Obiliqit, Komisioni e ka shqyrtuar, ka dalë në terren dhe i ka dërguar shkresë MMPHI-së.
- Kërkesa e banorëve të fshatit Marec, rreth ndotjes së lumit Marec nga miniera e Artanës. Komisioni ka dalë në terren për tu informuar rreth gjendjes dhe i ka dërguar shkresë ne MMPHI.

- Kërkesa e banorëve të fshatit Stanishor rreth operimit të nje numri të madhë te operimit të gurthyesve, Komisioni ka dalë në terren për tu informuar rreth gjendjes gjendjes dhe i ka dërguar shkresë ne MMPHI.
- Kërkesa e banoreve te fshatit Drajcici të Prizrenit, Komisioni e ka shqyrtuar.
- Shkresa e Gjykatës kushtetuese, Komisioni më 16.11.2021, e ka shqyrtuar shkresën e Gjykatës Kushtetuese nr. 2390/21 dhe i ka dërguar informatë.
- Shkresa për MMPHI për kërkesën e banorëve të Komunës së Shtërpçës për Hidrocentralet, në mbledhjen e mbajtur dt. 16.11.2021 u shqyrtua kërkesa, u sugjerua të dërgohet në MMPHI për një përgjigje rreth ndërtimit të hidrocentralit në këtë lokacion.

**g) Mbajtja e dëgjimeve publike**

Komisioni, në periudhën raportuese ka mbajtur një dëgjim publik, për Projektligjin nr.08/L-012 për odat e arkitektëve dhe inxhinierëve në fushën e ndërtimit. Dëgjimi u mbajtë më 4 tetor 2021 nën kryesimin e deputetit Milazim Salijaj, kryesues i grupit dhe Ekrem Mustafa, anëtar dhe me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të MMPHI-së, Liburn Aliu, Ministër; Driton Tafallari dhe Eljesi Surdulli, këshilltar; Servet Spahiu, drejtor; Florim Grajcevc, dekan i fakultetit të Ndërtimtarisë; Violeta Nushi, dekane e fakultetit të arkitekturës; Rozafa Basha fakulteti i arkitekturës; Arber Sadiki, kolegji UBT; Masar Dushi, asociacioni arkitekteve, Hamdi Sylejmani, Shoqata e Konstrukterve te Ndertimit; Murat Hoxha, Shoqata e gjeodeteve te Kosovës; Afrim Demiri, kryetar i bordit industrial - Fakultetit të ndërtimtarisë; Valdet Osmani nga Asociacioni i arkitektëve; Aferdita Zymberi dhe Modest Gashi nga UN-Habitati; Valon Dobruna, këshilltar juridik, Kuvendi.

**h) Mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve**

Komisioni, në kuadër të mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve, me planin e punës ka vendosur të mbikëqyrë zbatimin e 4 ligjeve dhe më13 korrik 2021 ka formuar grupet e punës, e të cilat janë plotësuar më 7 dhjetor 2021:

- *Mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit nr.04/L-147 për Ujërat e Kosovës, komisioni themeloi grupin e punës në këtë përbërje: Albena Reshitaj-kryesuese, Jetmira Vrenezi, Ganimete Musliu, Milazim Salijaj dhe Fitore Pacolli-Dalipi, anëtar. Grupi i punës me 23 nëntor 2021 e ka diskutuar dhe miratuar planin e veprimit për mbikëqyrje. Komisioni ka zgjedhur një ekspert për mbikqyrjen e këtij ligji.*
- *Mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit nr.04/L-114 për Pasurimin e Miellit, komisioni themeloi grupin e punës në këtë përbërje: Besian Mustafa-kryesues, Milazim Salijaj, Ganimete Musliu dhe Fitore Pacolli-Dalipi, anëtar. Grupi i punës, në takimin e mbajtur më 18.11.2021, ku i ftuar ishte eksperti i perzgjedhur i komisionit për këtë projektligj, e miratoi Planin i veprimit për mbikëqyrje dhe u bisedua për termat e referencës së angazhimit të ekspertit.*
- *Mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit nr.2003/3 për Pyjet e Kosovës, komisioni themeloi grupin e punës në këtë përbërje: Salih Zyba-kryesues, Isak Shabani, Besian Mustafa, Ekrem Mustafa,*

Samra Ilijazi dhe Fitore Pacolli-Dalipi, anëtar, gjithashtu është përzgjedhur një ekspert për mbikëqyrjen e këtij ligji.

- *Mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit nr.2003/5 për farërat*, komisioni themeloi grupin e punës në këtë përbërje: Ganimete Musliu - kryesuese, Salih Zyba, Jetmira Vrenezi, Besian Mustafa dhe Fitore Pacolli-Dalipi, anëtar, gjithashtu është përzgjedhur një ekspert për mbikëqyrjen e këtij ligji.

**i) Vizitat e komisionit brenda dhe jashtë vendit**

Komisioni, në periudhën raportuese, nuk ka bërë vizita jashtë vendit, ndërsa ka realizuar 18 vizita brenda vendit:

- Më 22 prill 2021, Fitore Pacolli-Dalipi- kryetare e Komisionit bashkë me Ministrin e MMPHI-së, z. Liburn Aliu, vizituan shtretërit e lumenjve në Shtërpcë, Brezovicë dhe Biti të Poshtme, për të parë nga afër shkatërrimin e shtretërve të lumenjve dhe dëmtimin e mjedisit nga hidrocentralet.
- Me 7 maj 2021, Fitore Pacolli-Dalipi, kryetare e Komisionit, me kërkesën e banorëve vizitoi fshatin Shalë të Lipjanit, dhe u njoftua nga afër me problemet që kanë me fillimin e operimit të një gurthyysi në zonën malore. Si dhe peticionin me 200 nënshkrime për kundërshtimin e fillimit të punës.
- Më 29 maj 2021, Fitore Pacolli-Dalipi, kryetare e Komisionit, bashkë me deputeten Arbëresha Kryeziu-Hyseni tash anëtare e Komisionit vizituan banorët dhe fermerët e fshatit Pogradjë të Gjilanit, për të parë nga afër dëmet e shkaktuara në bujqësi nga vërshimet.
- Më 11 maj 2021, komisioni vizitoi Agjencinë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës, dhe u takuan me drejtorin, z. Bislim Zogaj dhe stafin e Agjencisë, ku u diskutua në lidhje me raportin e punës dhe punën e Agjencisë.
- Më 19 maj 2021, anëtarët e komisionit: Fitore Pacolli-Dalipi, kryetare, Jetmire Vrenezi, Ekrem Mustafa dhe Fadil Nura-anëtarë, sipas peticionit të parashtruar, vizituan Komunën e Klinës, me ç’ rast u takua me kryetarin e Komunës së Klinës, z. Zenun Elezaj dhe fshatin Gremnik, ku u takuan me përfaqësuesit e fshatit dhe nënshkruesit e peticionit, për fabrikën e çimentos.
- Më 2 qershor 2021, anëtarët e komisionit: Fitore Pacolli-Dalipi, kryetare, Jetmire Vrenezi, Fadil Nura, Salih Zyba, Albena Reshitaj dhe Milazim Salijaj-anëtarë, kanë realizuar 3 vizita për çështjen e gurëthyesve: në Shalë të Lipjanit, Kervasari të Malishevës si dhe në Shkozë dhe në rrugën Shkozë-Zhur të Prizrenit. Pas vizitës, janë dërguar rekomandimet Ministrisë së Mjedisit.
- Më 9 korrik 2021, anëtarët e komisionit: Fitore Pacolli-Dalipi, kryetare, Ekrem Mustafa dhe Milazim Salijaj-anëtarë, realizuan një vizitë në Miradi të Ulët të Komunës së Fushë Kosovës për problematikën e ndotjes së lumit Graçanka dhe në ndërmarrjen “Bylmeti”. Gjatë kësaj dite gjithashtu është vizituar Instituti Bujqësor i Kosovës në Pejë, me ç’ rast nga drejtori, z. Fehmi Geci u njoftuan për punën, të arriturat, problemet dhe nevojat e këtij instituti.
- Më 13 korrik 2021, Fitore Pacolli-Dalipi, kryetare dhe deputetja Albena Reshitaj, së bashku me Jeta Statovci, nënkryetare e komisionit për ekonomi, Fatmire Kollçaku, kryetare e

Komisionit për Shëndetësi, kanë vizituar Komunën e Deçanit dhe KRU.“Hidrodrini”, me rastin e paraqitjes së helmimit të banorëve nga uji i pijshëm. për t’u njoftuar nga afër me gjendjen, delegacioni i Kuvendit takoi kryetarin e Komunës së Deçanit, Bashkim Ramosaj, në KRU.“Hidrodrini” me kryetarin e bordit Demë Abazi dhe kryeshefin Agron Tigani.

- Më 29 korrik 2021, Fitore Pacolli-Dalipi, kryetare dhe Ekrem Mustafa- anëtar, vizituan MMPHI-në dhe u takuan me zv. Ministrin, Z. Hysen Durmishi për të biseduar në lidhje me problemet në transportin e udhëtarëve, kriteret që duhet t’ i plotësojnë kompanitë e autobusëve dhe çështje të tjera nga kjo fushë.
- Më 4 gusht 2021, anëtarët e komisionit: Fitore Pacolli-Dalipi, kryetare, Salih Zyba, Albena Reshitaj dhe Milazim Salijaj-anëtarë, me qëllim të njohjes me dëmet që ka shkaktuar zjarri, realizuan një vizitë punë në Komunën e Suharekës, me ç’ rast u takuan me nënkryetaren znj. Mihrije Suka, pastaj vizituan qendrën zjarrfikësve në Suharekë dhe fshatin Bukosh, për të parë nga afër vatrat e zjarrit.
- Më 17 nëntor 2021, Fitore Pacolli-Dalipi-Kryetare e Komisionit, Milazim Salijaj dhe Salih Zyba-anëtarë, vizituan lokacionin arkeologjik i quajtur “Maja e Zezë” – në fshatin Grabovc i epërm dhe Sibovc në Komunën e Obiliqit, sipas kërkesës së banorëve për të ndaluar shkatërrimin e kësaj zone turistike dhe shumë me vlerë për banorët përreth. Aty prezent ishin disa banorë: Milaim Mjekiqi, Kastriot Mjekiqi, Milazim Kelmendi etj, të cilët kanë marr pjesë në vizitat lidhur me këtë rast, nga institucionet siç janë MMPH, KPMM etj. ku kanë parashtruar ankesa.
- Më 9 dhjetor 2021, komisioni, komisioni në përbërje nga Fitore Pacolli-Dalipi-kryetare dhe Milazim Salijaj-anëtarë i përcjellur nga stafi vizitoi disa lokacione sipas kërkesës së palëve: Vizita në shoqatën “99 lule” në fshatin Kishnicë; Vizita në magjistralen Prishtinë-Gjilan në fsh. Kishnicë, në afërsi të liqenit të Badovcit për shkak të rrëshqitjes së dheut; Vizita në fshatin Marec komuna Prishtinës rreth ndotjes së ujit në lumin Marec nga miniera e Artanës; Vizita në fshatin Stanishor komuna Novo Bërdë rreth gurthyesve në këtë lokacion, me çrast vizituan gurthyesit: “GLLAMA”, “KOFIX”, “PRO-N”, “ABI”, “GURI”, “AGIDANI”. Në fund të vizitës Komisioni u ndal në fshatin Livoç i poshtëm të Komunës Gjilanit për shkak të shqetësimeve të banorëve për kundërmimin e lumit, pasi që thertorja afër e ndotë lumin me mbeturina të thertores.

***j) Pritja e delegacioneve parlamentare të huaja (homologe)***

Anëtarët e komisionit: Fitore Pacolli-Dalipi, kryetare, Zoran Mojsilović zv. kryetar i dytë dhe Milazim Salijaj-anëtar, më 26 korrik 2021 janë takuar me një delegacion të ish-anëtarëve të Kongresit të SHBA-së: Mike Conaway, Nick Rahall dhe Peter Roskam. Ata prej 26 deri më 30 korrik qëndruan në Kosovë, në kuadër të programit House Democracy Partnership (HDP) të organizuar nga Instituti Republikan Ndërkombëtar (IRI), për të ofruar mbështetje teknike për Komisionin e cila ka të bëjë me përmirësimin e procesit legjislativ përmes operacioneve të komisionit me një fokus shtesë në hartimin e legjislacionit përmes mbështetjes specifike mbi çështjen legjislative.

**k) Aktivitete të tjera të kryetares dhe anëtarëve të komisionit**

Kryetarja dhe anëtarët e komisionit gjatë kësaj periudhe kanë zhvilluar edhe aktivitete të tjera:

- Anëtarët e komisionit: Fitore Pacolli-Dalipi, kryetare, Albena Reshitaj, Ekrem Mustafa dhe Milazim Salijaj-anëtarë, së bashku me stafin kanë marrë pjesë në trajnimin e organizuar nga Instituti Republikan Ndërkombëtar (IRI) në kuadër të programit House Democracy Partnership (HDP) për të ofruar mbështetje teknike për komisionin. Panelist në trajnim ishin 3 ish-anëtarë të Kongresit të SHBA-së: Mike ConaWay, Nick Rahall dhe Peter Roskam dhe stafi e zyrës qendrore të IRI-t dhe HPD në SHBA (prej 27-29 korrik 2021).
- Anëtarët e komisionit: Fitore Pacolli-Dalipi, kryetare, Milazim Salijaj dhe Ekrem Mustafa - anëtarë, kanë realizuar një bashkëbisedim me platformën ZOOM me 2 anëtarë të Kongresit Amerikan: Znj. Dina Titus dhe Z. Adrian Smith, u diskutua për politikën në infrastrukturë, transport, diversifikimin e burimeve të energjisë, shfrytëzimin dhe menaxhimin e qëndrueshëm të resurseve natyrore (më 29 korrik 2021).
- Takim i kryetares me deputetën e Parlamentit të Vjenës, znj. Mag. Heidi Sequenz, biseduan për mundësitë e bashkëpunimit për politikën shëndetësore dhe ato mjedisore (më 28 korrik 2021).
- Takim virtual i kryetares me kryetarin e Komisionit për Bujqësi të Parlamentit të Italisë, Filippo Gallinella, dhe Ambasadorin italian, Nicola Orlando, diskutim për praktikën më të mirë që aplikon Italia në zhvillim të bujqësisë, ruajtjen e biodiversitetit, mbrojtjen dhe mirëmbajtjen e pyjeve, menaxhimin dhe pasurimi i tokës bujqësore, alternativimi i prodhimit dhe përvojën e Italisë me kooperativat bujqësore (më 3 qershor 2021).
- Takim i kryetares me deputetën dhe raportuesen e Parlamentit Evropian për Kosovën, Viola von Cramon, diskutuan rreth punës së Komisionit, problemet që kanë shkaktuar hidrocentralet dhe gurëthyesit dhe ndikimin e tyre në mjedis, burimet kryesore të ndotjes së ajrit, ujit dhe tokës, dhe hapat që Kosova do të ndërmarrë në avancimin e agjendës së saj të gjelbër (më 28 qershor 2021).
- Komisioni dhe organizata UN-Habitat nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi. Marrëveshja u nënshkrua nga kryetarja e Komisionit për Bujqësi, Fitore Pacolli Dalipi dhe shefi i Zyrës së UN-Habitat-it në Kosovë, Omar Siddique. Marrëveshja parasheh bashkëpunimin në zhvillimin e politikave dhe legjislacionit të Kosovës, për të siguruar zhvillimin e qëndrueshëm urban në fushat e planifikimit hapësinor, mjedisit urban, klimën, lëvizshmëri urbane dhe strehim social, strehim të përballeshëm në përputhje me angazhimet transformuese të Agjendës së Re Urbane, Agjendës 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm dhe lokalizimit të SDG-ve (më 30 qershor 2021).
- Nënshkruhet marrëveshje bashkëpunimi me Friedrich Ebert Stiftung. Marrëveshja e nënshkruar nga kryetarja e komisionit, Fitore Pacolli- Dalipi dhe Rene Schlee, përfaqësues i Friedrich Ebert Stiftung, parasheh mbështetje në punën e komisionit në fushën e mjedisit të qëndrueshëm, duke ofruar ekspertizë dhe praktikën më të mirë ndërkombëtare (më 28 qershor 2021).
- Kryetarja takoi Shoqatën e Gjeodetëve të Kosovës, me të cilët bashkëbiseduan për bashkëpunimin për projektligjin për Kadastër të pronës së paluajtshme (më 22 korrik 2021).

- Kryetarja ka marrë pjesë në punëtorinë dyditore rreth identifikimit të politikave lokale, organizuar në bashkëpunim mes FES dhe NDI (prej 14-15 qershor 2021).
- Pjesëmarrja e kryetares në panelin e ngjarjes publike MoseMerrMalin, prezantoi punën dhe planet e komisionit në mbrojtjen e pyjeve dhe mjedisit. (më 29 korrik 2021).
- Anëtarët e Komisionit: Fitore Pacolli-Dalipi-kryetare, Milazim Salijaj-anëtarë, takuan profesorë nga Fakulteti i Bujqësisë si dhe anëtar e OJQ-së, diskutuan rreth përdorimit të pijeve energjetike nga të rinjtë, veçanërisht nga moshat nën 18 vjeç. Ofruan bashkëpunim për ndërmarrjen e një nisme për projektligjin për pije energjetike.(më 19 korrik 2021).
- Pjesëmarrje dhe paneliste në tryezën e organizuar nga instituti GAP, diskutim rreth ndikimit të subvencioneve dhe granteve në prodhimin bujqësor. (17 korrik 2021).
- Takimi i kryetares me zyrtar të EEAS dhe GIS-it, diskutim rreth menaxhimit të mbeturinave në Kosovë, ofruan bashkëpunim në këtë drejtim. (më 08 korrik 2021).
- Kryetarja e komisionit, realizoi edhe takime të tjera me qytetarë, OJQ vendore dhe ndërkombëtarë, ekspertë të fushave të ndryshme, me të cilat ka biseduar për problematikat e ndryshme dhe mundësitë e bashkëpunimit: Organizata për mbrojtjen e mjedisit “Gjethi”, “Balkan Green Foundation”, “Instituti i Prishtinës për Studime Politike”, “INDEP”, “EC ma ndryshe”, “Sustainability Leadership Kosova”, “NDI”, GIZ-i, “UNDP”, “Heinrich Böll Stiftung”, etj.
- Kryetarja e komisionit, morri pjesë në Tryezën e parë të Kryetarëve të Komisioneve Parlamentare të Kuvendit të Shqipërisë dhe Kuvendit të Kosovës, që u mbajt në mjediset e Kuvendit të Shqipërisë ( 6 tetor 2021).
- Deputetja Albena Reshitaj, ka marrë pjesë në prezentimin e organizuar nga organizata “Ec ma ndryshe” me temën “Reforma ligjore e planifikimit hapësinor të Kosovës në qorrsokak”, (dhjetor 2021).
- Kryetarja e Komisionit takoi Ambasadorin e Finlandës znj. Pia Stjernvall ku diskutuan rreth projekteve dhe punëve të përbashkëta midis dy vendeve, si dhe mundësinë e zgjerimit të bashkëpunimit tonë.(23 nëntor 2021).
- Kryetarja e Komisionit në kuadër të Ditës Botërore të Dheut #WorldSoilDay mori pjesë në inagurimit projektit e kompostimit komercial përmes skrajave në Lipjan (5 dhjetor 2021).
- Kryetarja e Komisionit takoi Ambasadorin e Republikës së Shqipërisë, Qemajl Minxhozi dhe Këshilltarin në Ambasadën e Republikës së Shqipërisë, Arthur Bushati. U dakorduan për bashkëpunim në çështjet e mjedisit, bujqësisë dhe infrastrukturës. zhvillojmë disa iniciativa dhe projekte të përbashkëta (6 dhjetor 2021).
- Kryetarja e Komisionit takoi Ambasadorin e Norvegjisë, u dakorduan të zhvillojmë disa iniciativa dhe projekte të përbashkëta që lidhen me fushveprimtarin e Komisionit ( 6 dhjetor 2021).
- Kryetarja e komisionit, lidhur me përdorimin në Kuvend të ujit të pijshëm nga rrjeti publik i ujësjellësit, zhvilloi një takim i përbashkët midis përfaqësuesve të Kuvendit, Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik dhe Kompanisë Ujësjiellësi Rajonal “Prishtina” (13 dhjetor 2021).

- Nënshkruhet marrëveshje bashkëpunimi me dy Organizata: “Fondacioni Jeshil” dhe Swiss Solidar” (14 dhjetor 2021).
- Kryetarja e Komisionit takoi Ambasadorin e Hungarisë z. Jóseph Bencze dhe znj. Krisztina Szabó, ku diskutuan rreth projekteve dhe punëve të përbashkëta midis dy vendeve , si dhe mundësinë e zgjerimit të bashkëpunimit tonë, kryesisht në fushën e bujqësisë, mjedisit dhe infrastrukturës. Me Ambasadorin Bencze, u dakorduan që të fillojmë bashkëpunimin bilateral mes komisioneve parlamentare të të dyja vendeve (16 nëntor 2021).
- Kryetarja e Komisionit zhvilloi takim me drejtoreshën ekzekutive të UNDP-së. Diskutuan rreth punës së Komisionit, problemet që kanë shkaktuar dhe gurëthyesit dhe ndikimin e tyre në mjedis, biseduan për mundësitë e bashkëpunimit për politikat mjedisore. Ofruan bashkëpunim në këtë drejtim (16 dhjetor 2021).
- Kryetarja e Komisionit priti në takim perfaqësues e e Odës së Veterinarëve të Kosovës e cila u njoftua rreth ligjeve të odave evropiane (20 dhjetor 2021).

#### IV REZYME E PUNËS SË KOMISIONIT

Tabela A – Pasqyrimi në formë tabelore i indikatorëve matës të punës së komisionit

Nr.	Indikatorët	total
1.	Numri i mbledhjeve të mbajtura	25
2.	Numri i pikave të rendit të ditës	125
3.	Procesverbale të hartuara	23
4.	Projektligje të shqyrtuara në cilësi të Komisionit Funkcional <i>(përfshirë edhe ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare)</i>	30
5.	Numri i amendamenteve të shqyrtuara në cilësi të komisionit të përhershëm <i>(të plotësohet vetëm nga komisionet e përhershme)</i>	-
6.	Projektligje në procedurën e shqyrtimit në komision	28
7.	Numri i grupeve punuese të formuara	12
8.	Numri i mbledhjeve të grupeve punuese	15
9.	Numri i raporteve të hartuara për projektligje në cilësi të komisionit të përhershëm <i>(të plotësohet vetëm nga komisionet e përhershme)</i>	-
10.	Numri i amendamenteve të shqyrtuara në cilësi të komisionit Funkcional	65
11.	Dhënia e mendimeve komisioneve të tjera	-
12.	Shqyrtimi i raporteve vjetore të institucioneve raportuese	4
13.	Shqyrtimi i kërkesave të institucioneve publike dhe private	8
14.	Rekomandime lidhur me propozimet për emërimin e anëtarëve të Bordeve të institucioneve/agjencive të pavarura nga Kuvendi	1



15.	Numri i vendimeve që i ka marrë komisioni	16
16.	Numri i raportimeve të ministrave	4
17.	Numri i raportimeve të autoriteteve tjera udhëheqëse	8
18.	Vizitat e realizuara jashtë vendit	-
19.	Vizitat e realizuara brenda vendit	26
20.	Dëgjime publike	1
21.	Monitorimi i ligjeve	-
22.	Monitorimi i ligjeve në procedurë në komision	4
23.	Tryeza-punëtori	-
24.	Shkresat e komisionit për subjektet/institucionet publike dhe private	3
25.	Pritja e delegacioneve të huaja	1
26.	Peticione të shqyrtuara	2
27.	Shqyrtimi i raporteve vjetore financiare të institucioneve dhe agjencive të pavarura	-
28.	Shqyrtimi i raporteve tremujore financiare të institucioneve/ agjencive të pavarura	-
29.	Raportimi i udhëheqësve të institucioneve/agjencive të pavarura në Komision	8
30.	Shqyrtimi i raporteve financiare, kërkesave buxhetore të Administratës së Kuvendit të Kosovës dhe raportimi për Kryesinë e Kuvendit	-
31.	Raporte të auditimit të shqyrtuara	-
32.	Shqyrtimi i Planit të performancës të Autoritetit të Aviacionit Civil dhe Planit i performancës të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës për vitin 2022	2

Raportin e përpiloi:

**Njësia për mbështetjen e komisionit**

Kryetarja e Komisionit,  
**Fitore Pacolli-Dalipi**